



## Projekti: Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare

### Janë realizuar katër këshillime për zgjidhjet ligjore të likuidimit



Në kuadër të projektit „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare,“ në periudhën prej 14 deri më 23 shkurt, janë mbajtur katër këshillime ku janë prezantuar aspekti maqedonas dhe evropian i mundësive ekzistuese ligjore për dalje të kompanive joaktive dhe insolvente nga tregu.

Është diskutuar edhe për mënyrat e likuidimit të shoqërive tregtare, kushtet e zbatimit të likuidimit vullnetar dhe të detyrueshëm, për fshirjen e shoqërive tregtare, si dhe për rolin e likuiduesëve në likuidim.

Në këto këshillime, ku morën pjesë mbi njëqind përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe të institucioneve kompetente shtetërore, të odave, avokatë dhe palë të tjera të interesuara, janë prezantuar shumë shembuj të paqartësive dhe mospërputhjeve në aplikimin e legjislacionit ekzistues, ndërsa janë miratuar edhe rekomandime për ndryshime të mëtutjeshme dhe përmirësime ligjore.

Projekti „Përmirësimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare“ ka për qëllim përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm afarist në Republikën e Maqedonisë, përmes mbylljes më të shpejtë të shoqërive tregtare, përmes procedurave të falimentimit dhe likuidimit vullnetar. Projekti realizohet me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA), të Bashkimit Evropian dhe zbatohet nga ana e konsorciumit të udhëhequr nga Pohl Consulting & Associates, në partneritet me Ernst&Young.

Shkup, 28.02. 2017





АДВОКАТСКА  
КОМОРА НА  
РЕПУБЛИКА  
МАКЕДОНИЈА

